



With funding from



# **UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN**

**QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE**

**Module trajnimi**

## **Universiteti “Ukshin Hoti” - Prizren (UUHP)**

### **Historik i shkurtër**

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren (UUHP), është një nga universitetet më të reja në Republikën e Kosovës. UUHP është themeluar më 09.10.2009 me vendimin nr. 01/87 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe filloi punën në vitin akademik 2009/10. Universiteti trashëgon përvojën e ish Shkollës së Lartë Pedagogjike, paralele e ndarë e Prishtinës, që funksionon nga tetori i vitit 1961, më vonë si Fakultet i Edukimit dega në Prizren, tani Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren.

UUHP aktualisht funksionon me gjashtë njësi akademike në ciklin Baçelor dhe Master ndërsa në bazë të statutit i njëjti mund të organizoj edhe studime të doktoratës. Përveç studimeve në gjuhën shqipe, universiteti ofron studime edhe në gjuhën turke dhe boshnjake.

UUHP është institucion akademik e konkurrues i orientuar në ofrimin e edukimit cilësor duke zhvilluar kërkime shkencore dhe duke kontribuar në inovacion, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

UUHP mbështetet në parimin e vlerave edukativo-kërkimore, përparësive krahasuese të diversitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor, me qëllim të krijimit të një qendre të ekselencës akademike e cila do t'i shërbejë studentëve, hulumtuesve dhe shoqërisë në fushat e TI, agrobiznesit dhe mjedisit, menaxhmentit dhe administrimit të biznesit, drejtësisë, gjuhësisë dhe edukimit.

## **Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM)**

UUHP funksionon në bazë të Statutit të miratuar nga Kuvendi të Republikës së Kosovës më 30.05.2013. Në kuadër të këtij statuti, gjendet edhe baza për Qendrën për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPS). Këshilli drejtues i UUHP ka miratuar *Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie*, me Nr. 01-296/A, të datës: 29.06.2022, përmes së cilës rregullohet funksionimi i gjithmbarshëm i saj.

QPM ka për qëllim ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve akademike si dhe promovimin e një kulture të përsosmërisë për mësimdhënie dhe të mësuar. QPM kontribuon në avancimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësuarit drejt rritjes së konkurrueshmërisë, mobilitetit dhe integritetit të personelit akademik të UUHP dhe më gjerë.

Organet e QPM-së janë: Këshilli administrativ; Këshilli i trajnerëve dhe Koordinatori dhe Zyrtari administrativ.

**Duke u bazuar në qëllimin e Rregullores, QPM zhvillon këto aktivitete:**

Hulumtimi dhe identifikimi i nevojave për trajnime në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies

-Identifikimi i mundësive dhe formave alternative për gjenerim të të ardhurave për QPM-në dhe Universitetin;

-Hartimi, zhvillimi dhe zbatimi i projekteve në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies për përmbushjen e standardeve të cilësisë;

-Zhvillimi dhe inkurajimi i zbatimit të metodave dhe formave moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies të cilat janë në përputhje me nevojat e universitetit dhe institucioneve tjera të arsimit të lart;

-Hartimi, zhvillimi dhe ofrimi i programeve të certifikuara të trajnimit dhe zhvillimit profesional për personelin e Universitetit dhe institucioneve tjera të arsimit të lartë;

-Zhvillimi/hartimi dhe ofrimi i programeve të certifikuara të trajnimit dhe zhvillimit profesional për nivelin e arsimit parauniversitar të përgjithshëm dhe profesional;

-Mbështetja dhe organizimi i konferencave, simpoziumeve, seminareve, punëtorive, vizitave studimore e arkitekteve me karakter profesional.

-Përgatitja e materialeve për programet që ofron QPM-ja;

-Kryerjen e shërbimeve për universitetin, përkitazi me mësimin *Gjatë Gjithë Jetës*;

-Zhvillimin e programeve të veçanta për përsosmëri në mësimdhënie dhe mësimnxënie, për përfituesin dhe palët e treta;

-Përgatitja e planeve vjetore dhe afatmesme për zhvillimin profesional të personelit akademik të universitetit.

# QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE

## Modulet e trajnimeve për stafin akademik të UUHP

Moduli	<b>Teoritë e të nxënit</b>
Mësimdhënësi/t – Trajneri/ët	Prof.ass.dr. Pranvera Jetishi Çollaku dhe Prof.ass.dr. Serdan Kervan
Orë	2
Grupi i synuar	Stafi akademik i UUHP

### Përshkrimi i shkurtër

Teoritë e të nxënit shpjegojnë faktet, ligjet dhe parimet në procesin e të nxënit. Autorë të ndryshëm, numrin e madh të teorive të të nxënit i grupojnë në disa lloje, sepse konsiderohet që secila prej tyre ka vlerë brenda një konteksti të caktuar, po ashtu nuk ekziston një teori e vetme që mund të shpjegojë se si formohen parimet apo si mbahen mend faktet, si dhe të shpjegojë se njeriu mund të përvetësojë një përmbajtje a definicion të ndërlikuar dhe abstrakt në një fushë të caktuar. Në përmbajtjen e përkufizimeve që i bëhen të nxënit nga çfarëdo këndvështrimi qoftë, vërehen disa elemente bazë të cilat e përbëjnë nocionin të nxënë, ato janë: ndryshimi dhe përvoja. Mbi bazën e këtyre proceseve teoritë e shumta për të nxënit sistemohen në grupe të shumta, por ne do ta vëmë theksin vetëm në teoritë më të njohura të të nxënit, si: teoria biehejvioriste, teoria konjitiviste, konstruktivizmi, teoria e të nxënit social, teoria e inteligjencave të shumëfishta, teoria humaniste etj. Në fakt asnjë teori nuk e shpjegon plotësisht procesin e të nxënit dhe të mësuarit, megjithatë të gjitha këto teori së bashku përbëjnë një kompleks të ideve që janë më afër të vërtetës së plotë. Trajtimi i secilës nga këto teori kontribuon në një aspekt të veçantë që na ndihmon të kuptojmë në tërësi këtë proces kaq kompleks, të të nxënit.

### Qëllimi i modulit

Moduli “*Teoritë e të nxënit*” fokusohet në trajtimin e koncepteve kryesore të këtyre teorive dhe zbatimin e tyre në mësimdhënie bashkëkohore me nxënës dhe studentë. Duke nxitur gjithëpërfshirjen e tyre në klasë, motivimin, fleksibilitetin, mësimin e diferencuar, mësimin përmes projekteve/hulumtimit, mendimin krijues, zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik. Pra, qëllimi i modulit të Teorive të të nxënit është të pajisë profesionistët me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që lidhen me teorinë dhe praktikën, për një mësimdhënie me studentin në qendër të procesit mësimor, që është sfida e pedagogjisë bashkëkohore.

## **Rezultatet e të nxënit**

- Demonstron një kuptim sistematik të aspekteve kyçe të teorive të të nxënit;
- Reflekton në mënyrë kritike mbi teoritë e të nxënit dhe zbatimin e tyre në praktikë;
- Zbaton teoritë e të nxënit në mësimdhënie duke nxitur motivimin, fleksibilitetin, zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik.

## **Metodologjia e mësimdhënies**

Moduli do të zhvillohet duke përdorur metodologji dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies, përmes mësimit interaktiv, diskutimeve, demonstrimeve, prezantimeve si dhe duke përdorur forma të ndryshme të punës, si individuale, dyshe, punës në grupe, etj.

Moduli	Të mësuarit aktiv
Mësimdhënësi/t – Trajneri/ët	Prof.asoc.dr. Vjollca Dibra dhe Prof.asoc.dr. Sejdi Sejdiu
Orë	2
Grupi i synuar	Stafi akademik i UUHP

### **Përshkrimi i shkurtër**

Të mësuarit aktiv është qasje e mësimdhënies që përfshin angazhimin aktiv të studentëve me materialin e lëndës përmes diskutimeve, zgjidhjes së problemeve, studimeve të rasteve, lojërave me role dhe metodave të tjera. Qasjet e të nxënit aktiv vendosin një shkallë më të madhe përgjegjësie mbi studentin sesa qasjet pasive siç janë ligjëratat, mirëpo roli i mësimdhënësit është vendimtar në orën e të mësuarit aktiv. Aktivitetet e të mësuarit aktiv mund të zgjasin nga disa minuta deri në tërë ligjëratën, ose mund të zhvillohen gjatë sesioneve apo aktiviteteve të veçanta në klasë. Të mësuarit aktiv nxitet përmes zbatimit të metodave apo teknikave ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat nxisin diskutimin në dyshe, në grupe, nxisin procesin e të lexuarit aktiv, procesin e të shkruarit dhe përgjithësisht zhvillojnë të menduarit kritik e krijues.

### **Qëllimi i modulit**

Moduli "*Të mësuarit aktiv*", ka për qëllim të zhvillojë te mësimdhënësit teknika e aktivitete të cilat ndihmojnë në promovimin e strategjisë *studenti në qendër*, përmes përdorimit të njohurive dhe shkathtësive të mëparshme të tyre, inkurajimin në debate, lexim e të shkruar akademik e krijues si dhe në përfshirje të një procesi reflektues për të mësuarit e tyre me qëllim të zhvillimit të mendimit kritik e krijues.

### **Rezultatet e të nxënit**

- Shpjegon të mësuarit aktiv si një përfshirje aktive në procesin e të mësuarit;
- Shton shkathtësi të zbatimit të teknikave ndërvepruese të mësimdhënies;
- Zhvillon shkathtësi profesionale për zbatim të ndërveprimit në klasë, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues;
- Ndërlidh të kuptuarit dhe zotërimin e informacionit përmes demonstrimit.

**Metodologjia e mësimdhënies**

Moduli do të zhvillohet duke përdorur metodologji dhe teknika ndërvepruese të mësimdhënies, përmes diskutimeve, demonstrimeve, prezantimeve si dhe duke përdorur forma të ndryshme të punës, si individuale, dyshe, punës në grupe, etj.



Moduli	<b>Teknikat ndërvepruese të mësimdhënies</b>
Mësimdhënësi/t – Trajneri/ët	Prof.asoc.dr. Mirvjena Kortoçi dhe Prof.ass.dr. Adelina Rakaj
Orë	<b>2</b>
Grupi i synuar	Stafi akademik i UUHP

### **Përshkrimi i shkurtër**

Teknikat ndërvepruese të mësimdhënies paraqesin mënyrën e veprimtarisë komunikuese në të cilën mësimdhënësi i përfshin studentët në procesin e të mësuarit dhe bën që ata të reflektojnë mbi atë që dinë dhe atë që mendojnë. Bazuar në njohuritë dhe përvojën e tyre, studentët kategorizojnë, analizojnë, supozojnë mendime, përvetësojnë njohuri, zhvillojnë shkathtësi të reja dhe zhvillojnë qëndrimet e tyre ndaj fakteve dhe ngjarjeve. Roli i mësimdhënësit transformohet në rolin e lehtësuesit të procesit të të mësuarit dhe është i orientuar drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta me studentët.

### **Qëllimi i modulit**

Moduli “*Teknikat ndërvepruese të mësimdhënies*” ka për qëllim t’i zhvillojë mësimdhënësit shkathtësitë e zbatimit të teknikave ndërvepruese të mësimdhënies. Përmes këtij moduli, synohet që mësimdhënësit në punën e tyre, të sigurojnë pjesëmarrje aktive të studentëve në procesin akademik dhe jo perceptim pasiv të informacionit prej tyre si dhe t’u mundësojnë studentëve aplikimin e njohurive në kushte reale, ku fokusimi qëndron në procesin e studimit dhe jo në kujtimin e informacionit.

### **Rezultatet e të nxënit**

- Interpreton rëndësinë e teknikave ndërvepruese në mësimdhënie si parakusht për të mësuar të suksesshëm;
- Identifikon rolin e mësimdhënësit në zbatimin e teknikave ndërvepruese të mësimdhënies;
- Zbaton teknika ndërvepruese të mësimdhënies në lëndët përkatëse.

**Metodologjia e mësimdhënies:**

Ndër qasjet ndërvepruese veçojmë: detyrat krijuese; përdorimi i burimeve njerëzore (ekskursione, ftesë ekspertësh); projektet sociale; përdorimi i materialit të ri (leksione interaktive, materiale video-audio, studenti në rolin e "mësuesit", dialogu Sokratik, duke bërë pyetje); zgjidhja e detyrave (hartat shoqëruese, stuhi mendimesh, analizë rasti).

Mësimdhënësi/t – Trajneri/ët	Prof.asoc.dr. Vedat Bajrami Prof.ass.dr. Fatmir Mehmeti
Orë	2
Grupi i synuar	Stafi akademik i UUHP

### **Përshkrimi i shkurtër**

Moduli “*Taksonomia e Blumit*”, përmban informacione të cilat ndërlidhen ngushtë me profesionin e mësimdhënësve, edukatorëve dhe profesionistëve të tjerë. Moduli ngërthen në vete informacione për tre domenet (fushat) hierarkike: domeni kognitiv, e cila paraqet mundësinë e personit të përpunoj dhe vlerësoj informatat nga rrethina e tij; domeni afektiv, e cila paraqet aspektin emocional të reagimit, te personit gjatë të nxëniti; domeni psikomotorik, i cili ka të bëjë me shkathtësitë.

### **Qëllimi i modulit**

Përmbajtjet që ofrohen në këtë modul iu mundësojnë pjesëmarrësve të identifikojnë, përshkruajnë, shpjegojnë, krahasojnë, analizojnë, argumentojnë dhe vlerësojnë të tre domenet (fushat) hierarkike të përdorura për të klasifikuar objektivat (rezultatet e të nxëniti) mësimore të arsimit në nivele kompleksiteti dhe specifike. Gjithashtu, moduli do t'i mundësojë pjesëmarrësve t'i zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë për zbatimin e niveleve të taksonomive përgjatë hartimit të rezultateve (të njësisve mësimore, syllabuseve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera mësimore), përgjatë vlerësimeve (teste dhe vlerësime të tjera të të nxëniti të studentëve) dhe në caktimin e metodave udhëzuese të tilla si strategjia e pyetjeve.

### **Rezultatet e të nxëniti**

- Përshkruan konceptet themelore të cilat i karakterizojnë të tri modelet (fushat) hierarkike;
- Demonstron shkathtësi në formulimin e rezultateve të të nxëniti duke u bazuar në nivelet taksonomive;
- Formulon pyetje duke u bazuar në nivelet e taksonomive.

### **Metodologjia e mësimdhënies**

Moduli trajtohet duke përdorur metodologji dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies, përmes mësimit interaktiv, diskutimeve, demonstrimeve, prezantimeve si dhe duke përdorur forma të ndryshme të punës, si individuale, dyshe, punës në grupe, etj.

Moduli	<b>Hartimi i rezultateve të të nxënit</b>
--------	---

Mësimdhënësi/t – Trajneri/ët	Prof.ass.dr. Ziriye Hasani dhe Prof.ass.dr. Anera Musliu
Orë	2
Grupi i synuar	Stafi akademik i UUHP

### **Përshkrimi i shkurtër**

Moduli “*Hartimi i rezultateve të të nxënimit*” ofron përmbajtje dhe zhvillon shkathtësi të hartimit të rezultateve të të nxënimit për programin, lëndët/kurset në të gjitha nivelet e studimit. Në radhë të parë, hartimi i rezultateve të të nxënimit është komponentë shumë e rëndësishme kur përpilojmë syllabuset e lëndëve në të gjitha nivelet e studimit. Në këtë pikë, tregohet se kush do jenë aftësitë e shkathtësitë e studentit pas përfundimit të një lënde apo programi studimor.

### **Qëllimet e modulit**

Përmbajtjet që ofrohen në këtë modul iu mundësojnë pjesëmarrësve të zhvillojnë shkathtësi të hartimit të rezultateve të të nxënimit për programin dhe më saktësisht për lëndën/kursin mbi bazën e foljeve vepruese, elementeve kryesore të rezultateve siç janë: veprimi, kushti dhe kriteri.

### **Rezultatet e të nxënimit**

- Identifikon foljet vepruese sipas niveleve të taksonomisë së Blumit;
- Përcakton elementet themelore të rezultateve të të nxënimit siç janë veprimi, kushti dhe kriteri;
- Harton rezultate të të nxënimit për lëndën/kursin.

**Metodologjia e mësimdhënies:** Jigsaw; parashtrimin i pyetjeve; brainstorming (stuhi mendimesh), punën në çifte, në grupe.

Moduli	<b>Hartimi i syllabusit</b>
--------	-----------------------------

Mësimdhënësi/t – Trajneri/ët	Prof. asoc.dr. Halim Bajraktari Ass. Shefki Shtërbani Dr.
Orë	<b>2</b>
Grupi i synuar	Stafi akademik i UUHP

### **Përshkrimi i shkurtër**

Moduli “*Hartimi i syllabusit*”, ka qëllim të mbështes stafin akademik për hartimin e syllabuseve, me standardet e kërkuara nga universiteti, që t’i përshkruajnë, shqyrtojnë, rishikojnë syllabuset e tyre për lëndët përkatëse. Procesi i hartimit të një syllabusi është një mundësi e mirë për mësimdhënësin që të reflektojë, në përputhje me standardet e kohës, duke e shtyrë atë të marrë në konsideratë metodologjinë e mësimdhënies, rëndësinë e lëndës, temat të cilat do të trajtohen, për çfarë kursi bëhet fjalë, pse mësohet lënda, çfarë do të kërkohet që studentët të jenë të suksesshëm në kurs etj. Një syllabus i hartuar mirë është një tregues mjaft i besueshëm i cilësisë nga mësimdhënësit dhe të nxënit që zhvillohet në një lëndë. Prandaj, i takon mësimdhënësve që të bëjnë përpjekje për të hartuar një program të standardeve më të larta, e të cilat do të trajtohen me organizimin, në zbatimin e modulit për mësimdhënësit lidhur me hartimin e syllabusit.

### **Qëllimi i modulit**

Moduli ka për qëllim të zhvillojë shkathtësi te mësimdhënësit për hartimin e syllabusit me standarde të kërkuara për një syllabus universitar. Kjo do të pasqyrojë perspektivën, për një syllabus adekuat ku përfshihen të gjitha elementet e nevojshme duke filluar nga përshkrimi i lëndës, qëllimi, rezultatet, aktivitetet, metodologjinë dhe procesin e vlerësimit të studentëve.

### **Rezultatet e të nxënit**

- Përcakton elementet themelore të një syllabusi sipas standarteve të kërkuara;
- Përfshin në secilën komponentë të syllabusit elementet e kërkuara;
- Harton syllabusin e lëndës/kursit sipas kritereve të përcaktuara.

## Metodologjia e mësimdhënies

Moduli trajtohet duke përdorur metodologji dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies, përmes mësimi interaktiv, diskutimeve, demonstrimeve, prezantimeve si dhe duke përdorur forma të ndryshme të punës, si individuale, dyshe, punës në grupe, etj.

### Plani kalendarik i trajnimeve 2022-2023

Trajnimet	Trajnerët	Koha e realizimit	Datat e realizimi	Pjesëmarrës të synuar
Teoritë e të nxënit	Pranvera Jetishi Çollaku Serdan Kervan	Dhjetor 2022	14.12.2022 (11:00-12:30)	2 gr/15 prs
Të mësuarit aktiv	Vjollca Dibra	Dhjetor 2022	14.12.2022 (13:30-15:00)	2 gr/15 prs
Teknikat ndërvepruese të mësimdhënies	Mirvjena Kortoçi Adelina Rakaj	Dhjetor 2022	19.12.2022 (10:00-11:30)	2 gr/15 prs
Taksonomia e Blumit	Vedat Bajrami Fatmir Mehmeti	Janar - Shkurt 2023	15.01.2023- 14.02.2023	2 gr/15 prs
Hartimi i rezultateve të të nxënit	Zirije Hasani Anera Musliu	Janar - Shkurt 2023	15.01.2023- 14.02.2023	2 gr/15 prs
Hartimi i planprogramit semestral (syllabus)	Halim Bajraktari Shefki Shtërbani	Janar - Shkurt 2023	15.01.2023- 14.02.2023	2 gr/15 prs

